

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies au  
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Seanca plenare**

Seanca nr.2004/07

Prishtinë, më 28 prill 2004, në orën 10:15

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Hydajet **Hyseni**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 75 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

**REND DITE:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
3. Shqyrtimi i planit për zbatimin e "Standardeve për Kosovën";
4. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës -nr.2003/33;
5. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për energjinë -nr.2004/06;
6. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për rregullatorin e energjisë -nr.2004/07;
7. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për energjinë elektrike -nr.2004/08;
8. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për njësitë matëse -nr.2004/09;
9. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për standardizim -nr.2004/10;
10. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për materialin fidanor -nr.2004/01;
11. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për marrëveshjet financiare ndërkombëtare -nr.2004/11;
12. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për kinematografinë e Kosovës -nr.2003/36;

13. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"-nr. 2004/05;
14. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve – nr.2004/12;
15. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për ndërtimet– nr.2004/13;
16. Shqyrtimi i raportit për gjendjen në minierat e Kosovës;
17. Shqyrtimi i rekomandimit për emërimin e prokurorëve dhe
18. Përgjigjet e ministrave pyetjeve të deputetëve.

Në fillim të seancës, kryetarët e grupeve parlamentare e kërkuan fjalën.

**Arsim Bajrami**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së shprehu pakënaqësi me zhvillimet e sotme në disa fshatra të Drenicës dhe me vazhdimin e tendencës së burgosjes së njerëzve jashtë rregullave të shtetit të së drejtës. Ne e gjykojmë arrestimin e zotit Sami Lushtaku dhe mendojmë se po vazhdon një tendencë e burgosjes dhe e inkriminimit të njerëzve më të merituar të këtij vendi dhe kërkojmë që këto praktika të ndërpriten.

**Sabri Hamiti**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoji që nga shqyrtimi i sotëm, të shtyhen për seancë tjetër pikat e propozuara të rendit të ditës: 11,12 dhe 13, ngase nuk janë bërë përgatitjet e nevojshme për shqyrtimin e tyre.

**Bujar Dugolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se nuk e përkrah propozimin për heqjen nga rendi i ditës shqyrtimin e projektligjeve, të propozuara nga Kryesia, ngase nuk ka arsye bindëse pse ato të hiqen.

**Tomë Hajdaraj**, në emër të Komisionit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, tha se kanë disa vërejtje në P/ligjin për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", të cilat duhen të inkorporohen në këtë p/ligj. Ai propozoi që ky p/ligj t'i kthehet sponsoruesit për riformulim.

**Arsim Bajrami** tha se nuk e përkrah propozimin për heqjen e p/ligjeve nga rendi i ditës. Vërejtjet mund të inkorporohen në tekstin e p/ligjit gjatë shqyrtimit, përmes amendamenteve.

Pas kërkesës për heqjen nga rendi i ditës dhe kundërshtimit të saj, Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që shqyrtimi i dytë i P/ligjit për marrëveshjet financiare ndërkombëtare, i P/ligjit për kinematografinë e Kosovës dhe i P/ligjit për parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", të shtyhen për seancën e ardhshme plenare.

## **2. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme**

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

### 3. Shqyrtimi i planit për zbatimin e “Standardeve për Kosovën”

Kryetari tha se në variantin e fundit në tekstin e Planit të “Standardeve për Kosovën” ka një ndryshim, në të cilin jepet një vlerësim i parakohshëm për ngjarjet e 17 dhe 18 marsit, të cilin Kuvendi nuk mund ta pranojë pa ndonjë analizë dhe vlerësim të përbashkët ndërmjet Kuvendit, UNMIK-ut dhe Qeverisë për ato ngjarje.

Sa i përket fushës së miratimit të ligjeve për zbatimin e standardeve, Kuvendi duhet ta përshpejtojë punën e vet.

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e planit për zbatimin e standardeve për Kosovën.

**Sabri Hamiti** tha se plani për zbatimin e standardeve për Kosovën është një dokument që e ka miratuar K S i OKB-së, të cilin në dhjetor të vitit të kaluar, e kanë pranuar dhe udhëhesit e institucioneve të Kosovës. Tani kemi variantin e dytë të tij, të cilin e ka miratuar Qeveria e Kosovës.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij plani, Komisioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Grupi Parlamentar i LDK-së kanë analizuar çfarë përmban programi për zbatimin e standardeve .

Qëndrimet tona janë me sa vijon:

- Zgjedhje të drejta e demokratike, me përfaqësim të vërtetë – proporcional të cilat do të prodhojnë një përfaqësim efektiv në të gjitha institucionet e Kosovës;
- Sundimi i ligjit;
- Zbatimi i të drejtave të barabarta në jetën dhe veprimtarinë në Kosovë të çdo qytetari;
- Rrespektimi i të drejtave të njeriut;
- Mosdiskriminimi, por edhe mosprivilegjimi i askujt;
- Zhvillimi i ekonomisë së tregut, me parakusht privatizimi në rastin konkret të ne;
- Lëvizja e lirë e qytetarëve;
- Garantimi i pronës individuale të çdokujt;
- Ndërtimi i politikës dhe i qëllimeve politike përmes dialogut.

Krejt këto janë premisa për një shoqëri demokratike, të cilat i synon Kosova dhe Programi i LDK-së.

Në anën tjetër, shtrohet menjëherë problemi - si të zbatohen këto standarde? Unë mendoj se këtu menjëherë dalin dy ose tri probleme themelore për zbatimin e tyre. Është puna e përgjegjësve për fushat që mbulojnë këto standarde. Shumicën e përgjegjësive i ka rezervuar pak në mënyrë – unë do të thosha – dogmatike UNMIK-u. Për t’u bërë zbatimi efektiv i standardeve, duhet shpejt të bëhet ridefinimi i raporteve ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe të UNMIK-ut .

Shkurt pra: duhet që të mirren kompetenca të veçanta në fusha të veçanta, në mënyrë që standardet të realizohen, për të cilat ne në princip pajtohemi.

Nën dy, teksti çfarë e kemi ne në dorë, në shumë pika ka retorikë politike dhe unë mendoj se është e gabueshme e cila është përzier pak a shumë me ngjarjet që kanë ndodhë në mars të këtij viti.

Nën tre, brenda hartimit të detyrave që dalin për zbatimin e standardeve janë edhe dy probleme që duhet të definojnë para se të mirren përgjegjësitë për realizimin e tyre.

Problemi i parë i strukturave paralele dhe së dyti i të ashtuquajturit decentralizim. Ne mendojmë se pa shpërbërjen e strukturave paralele – nuk mund të realizohen disa standarde që lidhen me problemin e integritit të minoriteteve në institucionin e Kosovës. Dhe tjetra edhe pse nuk figuron kërkund si standard - nën 8 – që quhet decentralizim, i cili nuk është elaboruar, por del si standard gati themelor. Lidhja Demokratike mendon që pa qendërzimin e pushtetit, pa efektivizimin e pushtetit të Kosovës nuk ka shansë të bëhet kurrfarë decentralizimi.

Ne i përkrahim “Standardet për Kosovën” si standarde për ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe të një Kosove si shtet demokratik dhe të pavarur.

**Arsim Bajrami**, në emër të Grpit Parlamentar të PDK-së, tha se “Standardet për Kosovën” janë një projekt politik dhe i kuptojmë si standarde për pavarësinë e Kosovës. Jemi të vetëdijshëm se këto standarde janë mbi nivelin e shteteve të tranzicionit, por u japim një mbështetje politike meqenëse ne nuk synojmë vetëm një Kosovë të pavarur, por synojmë edhe një Kosovë demokratike, një Kosovë evropatlantike. Ne këto standarde i shohim edhe si një strategji dalëse nga administrimi ndërkombëtar dhe nga Rezoluta 1244 dhe nga kjo gjendje e status quos, si një mekanizëm i cili do të mundësojë që në vitin 2005 të bëhet implementimi i vullnetit politik të popullit të Kosovës.

Duke i dhënë një përkrahje parimore procesit të standardeve, shprehim edhe disa vërejtje parimore, të cilat mendojmë se nuk përkojnë me faktin që këto standarde janë demokratike dhe synojnë një Kosovë me kritere evropiane.

Parakusht i parë që të shënohet një progres i dëshirueshëm për zbatimin e këtyre standardeve është fuqizimi i institucioneve të Kosovës me kompetenca dhe të fillojë bartja e menjëhershme e të ashtuquajturave fuqi të rezervuara.

Në këtë drejtim, Kuvendi i ka hyrë ndryshimeve në Kornizën Kushtetuese që do të bëjë të mundshëm që Kosova të marrë përgjegjësitë të cilat do t'i mundësojnë që të përmbushë sa më shpejt këto standarde. Përmes këtyre amendamenteve ne kemi kërkuar kompletimin e Qeverisë së Kosovës me të gjitha ministritë.

Meqenëse një bartje e përgjegjësisë - e cila është plotësisht në frymën e Rezolutës 1244 dhe e cila është një nga mandatet e misionit të Kombeve të Bashkuara - do të krijojë kushte objektive për zbatimin e standardeve.

Vërejtja e dytë është se pas ngjarjeve të marsit sikur ka ndërruar në koncept plani operacional dhe ne jemi të pakënaqur që ngjarjet e marsit merren si një nga treguesit e objektivave të standardit aq më parë kur për këto ngjarje ende s'kemi vlerësime të sakta dhe përfundimtare. Në tekstin e tanishëm, te çdo standard është futur kualifikimi për ngjarjet e marsit dhe treguesit operacional janë lidhur me këto ngjarje.

Vërejtja e tretë është se shumë objektiva janë kontroverse, inkompatibile, nuk janë koherente, nuk ka një kompozicion logjik teksti i planit operacional.

Vërejtja e katërt, duhet sakëtoshen treguesit real për vlerësimin e progresit në zbatimin e standardeve.

Vërejtja e pestë, është tendenca që në emër të standardeve evropiane, ne të instalojmë në Kosovë diçka që nuk është standard evropian. Në emër të mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve si një institucion, si një vlerë, ne nganjëherë zbatojmë metoda që s'i njuh demokracia e mirëfillt, pra japim diskriminime pozitive apo japim edhe konsesione që s'i njuh demokracia parlamentare. Në emër të mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve nganjëherë po shkilen të drejtat e shumicës dhe po thehen rregullat e parlamentarizmit.

**Bajram Kosumi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK –së, tha se janë dy dokumente për të cilat po diskutohet. Njëri është dokumenti i njohur si “Standardet për Kosovën”, i inicuar fillimisht nga zoti Grosman dhe të cilin në parim e kanë përkrahur forcat kryesore politike në Kosovë dhe tjetri është ai që quhet plan për zbatimin e standardeve për Kosovën.

Dallimi ndërmjet këtyre dy dokumenteve është evident.

Së pari dua të shtroj çështjen e autorsisë së këtij dokumenti. A është ky dokument dokument i përbashkët i UNMIK-ut dhe i institucioneve të Kosovës apo është dokument që e ka hartuar UNMIK-u ?

Çështja dytë, është ajo e “dhunës së 17 dhe 18 marsit”, si thuhet në dokument. Është përsëritur më shumë se 15 herë. Ky lokucion “dhuna e 17 dhe 18 marsit” nuk mund të rrijë mbi kokën e institucioneve të Kosovës si shpatë dhe nuk dëshirojmë të pranojmë diçka të tillë. Këto formulime politike duhet të spastrohen nga teksti.

Çështja e tretë, thelbësore ka të bëjë me bartjen e kompetencave. Në tërë programin flitet në mënyrë të hollësishme si duhet të arrihen këto standarde, por askund nuk flitet për bartjen e kompetencave. Pa bartjen e kompetencave nuk mund të ketë realizime të Standardeve, sepse përgjegjësia e institucioneve të Kosovës është e lidhur drejtpërdrejt me punën dhe me realizimin e këtyre standardeve.

Përfundimet tona lidhur me këtë plan janë si vijon:

Nën një: Nga një nismë e mirë diplomatike për çuarjen e procesit të përgjithshëm politik në Kosovë përpara, ajo nismë dalëngdalë po ngulfatet nga UNMIK-u duke e shndërruar atë në një dokument byrokratik.

Nën dy: Kuvendi i Kosovës duhet të shprehet qartë se politika e standardeve para statusit është një politikë e rrethit vicioz. Ne duhet të shprehemi qartë se e përkrahim realizimin e Standardeve për Kosovën në hap me bartjen e kompetencave tek institucionet e Kosovës dhe në hap me garancat ndërkombëtare për statusin final të Kosovës, i cili duhet të zgjidhet sipas vullnetit politik të popullit të Kosovës.

Qeveria dhe UNMIK-u duhet të spastrojnë tekstin në bazë të vërejtjeve që janë bërë dhe bëhen gjatë diskutimit në Kuvend.

Planit duhet t’i shtohet edhe një pjesë operationale për shuarjen e strukturave dhe të institucioneve paralele të Serbisë në Kosovë .

Kuvendi i Kosovës duhet t’i miratojë ndryshimet në Komizën Kushtetuese.

**Gani Sadik**, në emër të Grupit Parlamentar të komuniteteve të tjera, tha se e përkrahin planin për zbatimin e standardeve për Kosovën, por, kanë vërejtjet e tyre lidhur me qëndrimin organizatave ndërkombëtare, të cilat janë drejtuar vetëm nga bashkësia serbe dhe i kanë lënë pas dorë bashkësitë e tjera në Kosovë. Ndërsa, bashkësitë e tjera paraqesin një begati të shoqërisë së Kosovës dhe nuk dëshirojnë të jenë dekor i askujt, por të japin kontributin e tyre edhe në zbatimin e standardeve.

Ai falenderoi Kuvendin për mundësinë e përdorimit të gjuhëve dhe të shkrimit të dokumenteve zyrtare edhe në gjuhët e pakicave me të cilën po dëshmohet se standardet kanë filluar të zbatohen në jetën e përditshme në institucionet e Kosovës.

Gjuha turke duhet të përdoret dhe të mësohet edhe në ato komuna ku jetojnë turqit.



Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet e veta lidhur me planin për zbatimin e “Standardeve për Kosovën” i dhanë edhe këta deputetë: Zylfi Merxha, Muhamed Kelmendi, Fatmir Sejdiu, Hydajet Hyseni, Sanije Aliaj, Flora Brovina, Hasan Meta, Mahir Jakxhillar, Sabile Keçmezi-Basha, Smajl Latifaj, Nekibe Kelmendi, Ismajl Kurteshi, Fatmir Rexhepi, Berat Luzha, Sylejman Çerkezi, Naim Maloku, Xhevdet Neziraj, Teutë Hadri, Gani Prekopuca, Sadudin Berisha, Mehdi Bardhi dhe Sabit Rrustemi, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, Kuvendi nxori këto

#### **Përfunime:**

1. Formohet grupi i punës për përcjelljen e zbatimit të Planit për implementimin e Standardeve për Kosovën (pjesa që i referohet përgjegjësive të Kuvendit), në këtë përbërje:
  1. Sabri Hamiti, kryetar,
  2. Nekibe Kelmendi, anëtare,
  3. Arsim Bajrami, anëtar,
  4. Dragisha Krstoviq, anëtar,
  5. Bujar Dugolli, anëtar,
  6. Gani Sadik, anëtar dhe
  7. Isuf Demaj, anëtar.
2. Grupi i punës duhet t’i raportojë Kuvendit, një herë në muaj, për mënyrën e zbatimit të Planit për implementimin e “Standardeve për Kosovën”.

#### **4. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës**

**Kryetari** i informoi deputetët për procedurat e shqyrtimit të këtij p/ligji dhe për raportet me rekomandime të komisioneve. Komisionet parlamentare që kanë qenë të ngarkuara për shqyrtimin e këtij p/ligji i kanë bërë rekomandimet me amendamente që e përjashtojnë njëri-tjetrin. Me qëllim të mënjanimit të këtyre dallimeve, Kuvendi ka kërkuar nga Qeveria, si sponzuese e këtij p/ligji, të deklarojë për këto ndryshime. Qeveria e ka dhënë mendimi e vet lidhur me këto ndryshime, i cili u është shpërndarë deputetëve.

Komisioni për Ekonomi e Financa, si Komision referues e ka paraqitur raportin me amendamente që e përjashtojnë njëri-tjetrin dhe janë në kundërshtim me procedurat legislative, ngase e ka ndryshuar konceptin dhe emërtimin e p/ligjit që është miratuar në parim.

Ai kërkoi mendimin e deputetëve lidhur me këto ndryshime.

**Arsim Bajrami**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se amendamenti 1 i propozuar nga Komisioni Funkcional e ka zgjëruar dhe ndryshuar objektin e këtij p/ligji. Komisioni këtë propozim ka mundur ta bëjë më një nismë të re legislative, por jo në këtë

fazë të shqyrtimit të p/ligjit, ngase ai është miratuar në parim. Sipas proceduarave legislative, teknikës dhe logjikës juridike, në këtë fazë të shqyrtimit, nuk lejohet ndryshimi i objektit të p/ligjit.

**Fatmir Rexhepi**, në emër të Komisionit për Financa dhe Ekonomi, tha se e kanë shqyrtuar p/ligjin dhe vërejtjet lidhur më të dhe janë të mendimit që amendamenti 1 të mbetet ashtu siç është propozuar, për arsye se ligji duhet të mundësojë që Oda Ekonomike të organizohet në harmoni me sistemin e ri ekonomik, konkurrencën dhe rregullat e ekonomisë së tregut të lirë.

**Gani Sadik**, në emër të Grupit parlamentar të të tjerëve, tha se e përkrahin mendimin e Arsim Bajramit.

**Bujar Dugolli**, në të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se amendamentet 1 dhe 4 të propozuar nga Komisioni Funkcional nuk duhet të miratphen, ngase e ndërrojnë karakterin e p/ligjit. Duhet të miratohet varianti i propozuar nga Qeveria, të cilin Kuvendi e ka miratuar në parim.

**Haki Shatri** tha se Grupi Parlamentar i LDK-së i përkrah në tërësi amendamentet e Komisionit Funkcional, të cilat janë mbështetur edhe nga komisionet themelore.

Grupi Parlamentar i LDK-së është përcaktuar për modelin e anëtarësimit vullnetar, sepse ky model është preferuar nga pjesëmarrësit në diskutimin publik për këtë projektligj të organizuar nga ana e Komisionit Funkcional.

Përcaktimi për këtë model të organizimit të Odës Ekonomike dhe asociacioneve të tjera bëhet për ta shprehur disponimin tonë ndaj modelit Anglo-Amerikan, sepse ky model respekton të drejtën elementare të zgjedhjes së lirë, konkurrencën dhe e eviton monopolin.

**Nekibe Kelmendi** tha se Komisioni Funkcional, gjatë punës së vet e ka ndryshuar emërtimin e këtij ligji, që konsideroj se nuk ka vepruar drejt. Komisioni do të duhej ta përmirësojë amendamentin apo ta tërheqë një pjesë të amendamentit numër 1 dhe numër 4 sa i përket asociacioneve tjera të Odës dhe të mbetet emërtimi: Ligji për Odën Ekonomike të Kosovës.

Pas këtyre interpretimeve, kryetari i hodhi në votë , veç e veç, amendamentet e propozuara në këtë p/ligj nga Komisioni Funkcional, të koalicionit "Kthimi" dhe të deputetit Bedri Selmani.

Kuvendi, me shumicë votash, i miratoi këto amendamente: 5, 14, 15, 18, 23a, 29a dhe 41a (paragrafi 1).

Ndërsa i refuzoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29b, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41a (paragrafi 2) dhe b, 42, 43 dhe 44.

Pastaj kryetari e hodhi në votë P/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----73;  
Kundër----- 3;  
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi Ligjin për Odën Ekonomike të Kosovës.

Seanca përfundoi punimet në orën 16:00.

**Vazhdim i seancës më 29 prill 2004**

#### **5. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për energjinë**

Kryetari i informoi deputetët për procedurat e shqyrtimit të këtij p/ligji dhe për raportet me rekomandimet e komisioneve parlamentare.

Ai i hodhi në votë,veç e veç, amendamentet e Komisionit FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Pastaj kryetari e hodhi në votë P/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----71;  
Kundër----- 0;  
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi Ligjin për energjinë.

#### **6. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për rregullatorin e energjisë**

Kryetari i informoi deputetët për procedurat e shqyrtimit të këtij P/ligji dhe për raportet me rekomandimet e komisioneve parlamentare.

Ai i hodhi në votë,veç e veç, amendamentet e Komisionit FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi këto amendamente:1, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32 dhe 33, kurse e refuzoi amendamentin 2.

Pastaj kryetari e hodhi në votë p/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----70;



Kundër----- 1;  
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi Ligjin për rregullatorin e energjisë.

### **7. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për energjinë elektrike**

Kryetari i informoi deputetët për procedurat e shqyrtimit të këtij p/ligji dhe për raportet me rekomandimet e komisioneve parlamentare.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Pastaj kryetari e hodhi në votë P/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----70;  
Kundër----- 1;  
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi Ligjin për energjinë elektrike.

### **8. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për njësitë matëse**

Seancën e kryesoi **Hydajet Hyseni**, anëtar i Kryesisë.

Kryesuesi i informoi deputetët për procedurat e shqyrtimit të këtij p/ligji dhe për raportet me rekomandimet e komisioneve parlamentare.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit FunkSIONAL dhe të Komisionit për Buxhet.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Pastaj kryesuesi e hodhi në votë P/ligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----71;  
Kundër----- 0;  
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi Ligjin për njësit matëse.

## **9. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për standardizim**

Kryesuesi i informoi deputetët për procedurat e shqyrtimit të këtij P/ligji dhe për raportet me rekomandimet e komisioneve parlamentare.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit FunkSIONAL dhe të Komisionit për Buxhet.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19.

Pastaj kryesuesi e hodhi në votë P/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----71;

Kundër----- 0;

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës, njëzëri, e miratoi Ligjin për standardizim.

## **10. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për materialin fidanor**

Kryesuesi i informoi deputetët për procedurat e shqyrtimit të këtij p/ligji dhe për raportet me rekomandimet e komisioneve parlamentare.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit FunkSIONAL dhe të Komisionit për Buxhet.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15..

Pastaj kryesuesi e hodhi në votë p/ligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----71;

Kundër----- 0;

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi Ligjin për materialin fidanor.

## **11. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve**

**Kryesuesi** e ftoi sponsoruesin e këtij p/ligji, ta arsyetonte atë para deputetëve të Kuvendit.

**Ministri Ali Jakupi** e arsyetoi nevojën e nxjerrjes së këtij ligji, qëllimet dhe objektivat që synon t'i realizojë ai, si dhe materien e normuar në shtatë kapituj dhe pesëdhjetenjë nene.

Ai i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë p/ligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij p/ligji në parim.

**Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet e veta për këtë p/ligj i dhanë këta deputetë: Gani Prekopuca, Bedri Selmani, Sebahate Krasniqi, Sabit Rrustemi dhe Teutë Hadri, që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij p/ligji në parim dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----69;

Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi në parim P/ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve dhe i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin Funkcional ta shqyrtojnë këtë p/ligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

## **12. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për ndërtimet**

**Kryesuesi** e ftoi sponsoruesin e këtij p/ligji, ta arsyetonte atë para deputetëve të Kuvendit.

**Ministri Et'hem Çeku** e arsyetoi nevojën e nxjerrjes së këtij ligji, qëllimet dhe objektivat që synon t'i realizojë ai, si dhe materien e normuar në dhjetë kapituj dhe gjashtëdhjetegjashtë nene.

Ai i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë p/ligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij p/ligji në parim.

**Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet e veta për këtë p/ligj i dhanë këta deputetë: Naim Maloku, Remzije Nimani, Berat Luzha, Zylfije Hundozi, Blerim Baruti, Xhelal Canziba, Sala Ahmeti, Nafije Berisha dhe Fadil Kryeziu që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij p/ligji në parim dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----69;

Kundër----- 0;

Abstenime---- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës, njëzëri, e miratoi në parim p/ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve dhe i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin Funkcional ta shqyrtojnë këtë p/ligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

### 13. Shqyrtimi i raportit për gjendjen në minierat e Kosovës

**Kryesuesi** e ftoi kryetarin e Komisionit për Tregti dhe Industri ta paqesë raportin e hartuar për gjendjen në minierat e Kosovës.

**Bajrush Xhemajli** tha se Komisioni për Tregti dhe Industri i ka vizituar të gjitha minierat e Kosovës, ka mbledhur materialet relevante me shkrim dhe me gojë për gjendjen në miniera dhe mbi këtë bazë ka hartuar raportin, i cili u është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Në raport nuk është përfshirë gjendja në minierat e thëngjillit, ngase më herët kur Kuvendi e ka shqyrtuar gjendjen në KEK është diskutuar për to.

Minierat që prej hapjes së tyre e deri në mbarim të luftës kanë punuar. Ndërsa, tani – edhe pesë vjet pas luftës ato nuk janë aktivizuar. Për shembull “Trepça”, pavarësisht se nën cilin sundim ka funksionuar, ajo është shfrytëzuar në mënyrë koloniale, kurse tani kur ajo administrohet nga UNMIK-u – nuk punon. Nga kjo edhe shtrohet dilema: a janë minierat e Kosovës problem ekonomik, politik apo edhe njëra edhe tjetra

Rrezervat e minieraleve, që është bazë për minierat, në të gjitha minierat e Kosovës – Trepçë, Feronikël, Strezoc, Magurë dhe Volliak – janë të mjaftueshme për dekada të tëra që të punohet. Vetëm nevojiten investime, jo aq të mëdha, që ato të aktivizohen.

Komisioni ka konstatuar se në Trepçë ka probleme në harmonizimin e qëndrimeve ndërmjet vendorëve dhe UNMIK-ut dhe ka munguar vullneti UNMIK-ut për zgjidhjen e problemeve, me të cilat po ballafaqohet Trepça. Prandaj, menaxhmenti është duke u përballë me probleme të panevojshme.

Trepça, në administrim të UNMIK-ut, nuk ka status juridik. Nuk është e regjistruar në regjistrin e bizneseve, kurse “Trepça Holding Company” d.d. – KZMK Trepça, në fakt – vepron në pjesën veriore të Kosovës. Kjo pjesë e Trepçës në veri është regjistruar në Prishtinë kohë më parë, pastaj në Gjykatën Ekonomike të Prishtinës. Por e keqja qëndron se stafi menaxhues vendor nuk ka qasje në atë pjesë, por vetëm Beogradi dhe UNMIK-u. Pastaj, probleme krejt politike kanë edhe minierat e Feronikelit. Minierat aq rentabile të Feronikelit nuk mund të shfrytëzohen për shkak të mosinvestimit të nevojshëm në kapacitetet prodhuese, në metalurgjinë si finalizuese të përpunimit të mineralit.

Është një kontrast i çuditshëm në minierat e Kosovës. Aty ku minierat janë të gatshme për punë si në Strezoc dhe Volliak, pra minierat e magnezitit dhe boksitit – nuk kanë ku t'i shesin prodhimet, sepse tregjet janë humbur. Ndërsa, ato miniera, ku prodhimi i minieraleve ka treg të mjaftueshëm dhe të gjitha minierat e tjera, nuk janë aktivizuar.

Miniera e magnezitit në Magurë ka punuar deri në momentet e fundit të përfundimit të luftës. Por, përkundër faktit se ka xehe shumë të pasur, dhe do të mund të aftësohet dhe përparonte pozitivisht, është lënë të përmytet në ujë.

Edhe miniera me përbërjen më të mirë metalore në Evropë – 35% metal, ajo e Hajvalisë është lënë të përmytet në ujë. Si duket, qëllimi i ndokujt është që minierave të Kosovës t’iu ndodhë pikërisht kjo gjë.

Grupi i punës, në bashkëpunim me ekspertët vendorë për miniera, për të dalur nga kjo gjendje i rekomandon Kuvendit t’i miratojë këto

#### **Përfundime:**

1. Nxjerrjen e ligjit për minierat;
2. Nxjerrjen e ligjit për konsesione;
3. Minierat të mos privatizohen (së paku në këtë gjendje – kohë dhe rrethana)
4. Trepça të regjistrohet si kompani e vetme dhe e pandarë në Kosovë;
5. Të bëhet transferi i kompetencave të minierave tek vendorët;
6. Përpunimin e strategjisë për kahjet e zhvillimit të minierave dhe funksionimi i përgjegjësive pa përjashtim nëse nuk realizohet ajo strategji;
7. Një pjesë e suficitit, të mbetur nga viti 2003 i buxhetit të konsoliduar të Kosovës të ndahet për funksionalizimin e minierave;
8. Të bëhet normë që në ndërtimin e rrugëve, si shtresë e parafundit në asfaltimin e tyre të përdoret guri i andezitit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për raportin e këtij komisioni lidhur me gjendjen në minierat e Kosovës.

**Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet për gjendjen në minierat e Kosovës i dhanë edhe këta deputetë: Fatmir Rexhepi, Bujar Dugolli, Ibush Jonuzi, Ilmi Ahmeti, Bedri Selmani, Blerim Baruti, Hasan Meta, Gani Prekopuca, Behxhet Brajshori, Smajl Latifaj, Mehdi Bardhi, Ali Sadria dhe Sabri Hamiti që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë raportin me vërejtjet e diskutuesve dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;  
Kundër----- 0;  
Abstenime ----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi raportin me rekomandime të Komisionet për Tregti dhe Industri, me vërejtjet e deputetëve, për gjendjen në minierat e Kosovës.

#### 14. Shqyrtimi i rekomandimit për emërimin e prokurorëve

**Arsim Bajrami**, në emërt të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushteuese, e arsyetoi rekomandimin për emërimin e prokurorëve.

Komisioni rekomandimin e kishte ndarë në tri pjesë. Në pjesën e parë, kishte rekomanduar emërimin e 26 prokurorëve, të cilët i plotësonin kushtet, sipas Rregullorës së UNMIK-ut. Në pjesën e dytë, kishte kërkuar të dhëna shtesë nga Këshilli Prokurial dhe Gjyqësor për disa kandidatë. Në pjesën e tretë, për gjashtë kandidatë nuk e kishte dhënë pëlqimin, ngase nuk i plotësonin kushtet për ta ushtruar detyrën e prokurorëve.

Kryesuesi e hapi diskutimin lidhur me rekomandimin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushteuese.

Pas diskutimeve të **Lirak Çelës, Sabit Rrustemit, Muhamet Kelmendit, Qazim Kabashit, Fatmir Rexhepit, Sabri Hamitit, Agim Krasniqit, Blerim Barutit, Bajrush Xhemajlit, Fadil Kryeziut, Ismajl Kurteshit, Smajl Latifajt, Teutë Hadrit dhe Bujar Dugollit** lidhur me rekomandimin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushteuese për emërimin e prokurorëve, Kuvendi me shumicë votash, nxori këtë

#### **Përfundim:**

1. Vendimi për emërimin e prokurorëve shtyhet për seancën e ardhshme plenare.

#### 15. Përgjigjet e ministrave pyetjeve të deputetëve

**Kryeministri Bajram Rexhepi** iu kishte përgjigjur, me shkrim, pyetjes së deputetit Lulzim Zeneli lidhur me hartimin e P/ligjit për media.

**Deputeti Lulzim Zeneli** tha se nuk është i kënaqur me atë përgjigje dhe kërkon përgjigje gojore nga kryeministri.

Seanca përfundoi në orën 15:15 minuta.

#### Vazhdim i seancës më 6 maj 2004

#### Rendi i punës:

1. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për marrëveshjet financiare ndërkombëtare- nr.2004/11;
2. Shqyrtimi i rekomandimit për emërimin e prokurorëve.



Në fillim të seancës, kryetarët e grupeve parlamentare kërkuan fjalën.

**Bujar Dugolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se Kuvendi i Kosovës duhet ta kundërshtojë planin e Kuvendit të Serbisë për autonomin territoriale të serbëve në Kosovë.

Gjithashtu të kërkohet nga përfaqësuesi i PSSP-së, z. Holkeri të mos përzihet në planet e Serbisë.

**Arsim Bajrami**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se i ashtëquajtimi plan i Serbisë “ për autonomin territoriale të serbëve në Kosovë” është një sfidë për institucionet e Kosovës dhe është në kundërshtim edhe me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së.

Kuvendi në një seancë të veçantë duhet ta diskutojë këtë çështje dhe ta miratojë një rezolutë lidhur me të.

**Sabri Hamiti**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se është e nevojshme që Kuvendi të reagojë lidhur me atë plan të Serbisë. Sot nuk duhet të hapet diskutimi për të. Duhet ta përgatitim një plan të përbashkët, ndërmjet grupeve parlamentare, për zhvillimet e ardhshme të Kosovës, pavarësisht prej planeve të tjerëve.

**Kryetari** tha se institucionet e Kosovës janë deklaruar kundër planit të Serbisë për autonominë e serbëve të Kosovës.

Ai i përkrahu propozimet e parafolësve që Kuvendi të reagojë për atë plan, por duhet të analizohen rrethanat dhe të hartohet një dokument përkatës për kahjen e zhvillimeve të proceseve politike në Kosovë, të cilin do ta miratonte Kuvendi, në njërin nga seancat e ardhshme.

## **1. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për marrëveshjet financiare ndërkombëtare**

Kryetari i informoi deputetët për procedurat e shqyrtimit të këtij p/ligji dhe për raportet me rekomandimet e komisioneve parlamentare.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Financa dhe Ekonomi dhe të Komisionit për Buxhet.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Pastaj kryetari e hodhi në votë p/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për----- 79;

Kundër----- 1;

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi Ligjin për marrëveshjet financiare ndërkombëtare.

## 2. Shqyrtimi i rekomandimit për emërimin e prokurorëve

**Arsim Bajrami**, në emër të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese e arsytoi, para deputetëve, rekomandimin për emërimin e prokurorëve.

Pas diskutimeve të Ismajl Kurteshit, Ramadan Kelmendit dhe Bujar Dugollit, Kuvendi me shumicë votash, e miratoi këtë

### V E N D I M

#### 1. Për emërimin e këtyre kandidatëve:

1. Suad Kuraja, në Prokurorinë Publike të Qarkut në Prishtinë,
2. Besim Kelmendi, në Prokurorinë Publike të Kosovës,
3. Vesel Jashari, në Prokurorinë Publike të Kosovës,
4. Ismet Kabashi, në Prokurorinë Publike të Kosovës,
5. Jetish Maloku, në Prokurorinë e Qarkut në Gjilan,
6. Ndrec Dodaj, në Prokurorinë e Qarkut në Pejë,
7. Rexhep Rexhepaj, në Prokurorinë e Qarkut në Prizren,
8. Hysen Gashi, në Prokurorinë e Qarkut në Prizren,
9. Hashim Qollaku, në Prokurorinë e Qarkut në Prizren,
10. Allty Suroy, në Prokurorinë e Qarkut në Prizren,
11. Halil Dragaj, në Prokurorinë Publike Komunale në Mitrovicë,
12. Ali Rexha, në Prokurorinë e Qarkut në Mitrovicë,
13. Ibrahim Berisha, në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë,
14. Nazim Sllamniku, në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë,
15. Duhina Hamiti, në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë,
16. Sahit Krasniqi, në Prokurorinë Publike Komunale në Ferizaj,
17. Rasim Maloku, në Prokurorinë Publike Komunale në Ferizaj,
18. Florije Shamolli, në Prokurorinë Publike Komunale në Ferizaj,
19. Murat Hulaj, në Prokurorinë Publike Komunale në Pejë,
20. Mehdi Sefa, në Prokurorinë Publike Komunale në Prizren,
21. Bajram Hamitaga, në Prokurorinë Publike Komunale në Prizren,
22. Naim Beka, në Prokurorinë Publike Komunale në Mitrovicë,
23. Natasha Taniq, në Prokurorinë Publike Komunale në Mitrovicë,
24. Sabri Ademi, kandidat rezervë në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë,,
25. Faik Osmani, gjyqtar, Oda e veçantë e Gjykatës Supreme në Prishtinë.
26. Afrim Shefkiu, në Prokurorinë Publike të Qarkut në Gjilan,
27. Jovo Radoviq, në Prokurorinë Publike të Qarkut në Mitrovicë,
28. Xhevdet Bislimi, në Prokurorinë Publike të Qarkut në Mitrovicë,
29. Haki Gecaj, në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë,

30. Faik Halilaj, në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë,
31. Nuhi Paçarizi, në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë,
32. Imer Beka, në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë,
33. Ferdane Sylejmani, në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë,
34. Bedrije Sylja Alshiqi, në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë,
35. Agron Uka, në Prokurorinë Publike Komunale në Gjiilan,
36. Metush Biraj, në Prokurorinë Publike Komunale në Prizren,
37. Nexhdet Broqi, në Prokurorinë Publike Komunale në Pejë,
38. Fahri Nuhiu, në Prokurorinë Publike Komunale në Gjiilan,
39. Ervehe Gashi, në Prokurorinë Publike Komunale në Prizren,
40. Enver Sokoli, në Prokurorinë Publike Komunale në Prizren.

2. Kuvendi kërkon nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës të dhëna shtesë për kandidatin:

1. Reshat Millaku, në Prokurorinë Publike të Kosovës.

3. Kuvendi e shtyu vendimin për kandidatin, Abdyl Mazrekun, në Prokurorinë Publike Komunale në Prizren, ngase të dhënat për te kishin aritur me vonesë.

4. Kuvendi nuk e miratoi emërimin e këtyre kandidatëve:

1. Feti Tunuzliu, në Prokurorinë Publike të Qarkut në Prishtinë, ngase të njejtin e kishte refuzuar edhe më herët;
2. Nazmi Mustafa, në Prokurorinë Publike Komunale në Prizren, ngase ai gjatë viteve 1992 - 1995, kishte zbatuar ligje diskriminuese dhe
3. Zlatan Saviq, në Prokurorinë Publike të Qarkut në Mitrovicë, ngase ai ishte duke e ushtruar funksionin e gjyqtarit në Leskovc të Sërbisë.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 10:40 minuta.

**Sekretaria e Kuvendit**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
Akademik **Nexhat DACI**

---